



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

**AD-GJTHPZ.nr.10/24**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesve R.Sh., E.B., T.Sh., B.H., dhe R.Sh., që të gjithë nga fshati Restelicë, Komuna e Dragashit, respektivisht të përfaqësuesit të tyre av.A.R., nga Dragashi, ndaj gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr.42/23, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.19.08.2024, mori këtë:

## **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e ankuesve R.Sh., E.B., T.Sh., B.H., dhe R.Sh., që të gjithë nga fshati Restelicë, Komuna e Dragashit, respektivisht të përfaqësuesit të tyre av.A.R., nga Dragashi ndaj gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr.42/23.

## **A r s y e t i m**

Parashtruesit e ankuesve R.Sh., E.B., T.Sh., B.H., dhe R.Sh., që të gjithë nga fshati Restelicë, Komuna e Dragashit, respektivisht përfaqësuesi i tyre av.A.R., nga Dragashi, me datë 01.08.2024 ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtarit sipas lëndës penale P.nr.42/23.

Ankuesi av.A.R., nga Dragashi në kërkesën e paraqitur ka deklaruar se, në këtë çështje penale kanë dështuar të mbahen dy seanca të caktuara për shkak të mungesës së të akuzuarit M.M., dhe gjyqtari i çështjes edhe përkundër faktit se dy seancat e dështuara kanë qenë dashur të mbahen në degën e gjykatës në Dragash, i njëjti fare nuk ka ardhur për gjykim në degën e gjykatës në Dragash. Avokatët e paraqitur për të marrë pjesë në seancë, kanë pritur në objektin e gjykatës ku pas kalimit të orarit të caktuar për seancë, nga ndihmës administratori janë njoftuar se gjykimi nuk do të mbahet për shkak të mungesës së të akuzuarit. Ankesën e paraqesin sepse edhe përkundër faktit se i akuzuari M.M., ka qenë në Kosovë, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për sigurimin e prezencës së tij në këtë çështje penale. Përkundrazi edhe pse të dëmtuarit kanë pasur përfaqësuesit e tyre me autorizim, gjyqtari F.K., me datë 04.01.2024 ka lëshuar urdhër arrest me të cilin ka urdhëruar arrestimin e të dëmtuarve — dëshmitarëve me arsyetimin se nuk

kanë prezantuar në seancën e shqyrtimit fillestar të datës 29.12.2023. Ky konstatim i gjyqtarit të çështjes nuk qëndron për faktin se i dëmtuari T.Sh., jeton në fshatin Restelicë, Komuna e Dragashit, andaj në momentin e parë që do të dërgohej ftesa për seancë i njëjti do të paraqitej në gjykatë. Si rezultat i këtij urdhër arresti, i dëmtuari R.Sh., me datë 13.06.2024 me të ardhur në kufirin e Republikës së Kosovës është arrestuar nga i është marrë pasaporta nga zyrtarët policor të Stacionit Policor në Dragash dhe e kanë urdhëruar që me datë 14.06.2024 të paraqitet në zyrën e gjyqtarit F.K.. Me këtë datë i dëmtuari R.Sh., në prezencën e av.A.R., është paraqitur në zyrën e gjyqtarit F.K., i cili ka pranuar që e ka lëshuar urdhër arrest me arsyetim se të dëmtuarit nuk janë përgjigjur ftesës së gjykatës. I dëmtuari R.Sh., i ka treguar se asnjëherë nuk ka pranuar ftesë dhe ka kërkuar sqarime se pse pa u ftuar në mënyrë të rregullt është lëshuar urdhër arrest, ndërsa gjyqtari ka deklarua se duhet të presim një orë deri i akuzuari M.M., të paraqitet në gjykatë, pasi që i njëjti merret me bagëti dhe gjendet në bjeshkë dhe meqenëse i njëjti nuk lajmërohet në telefon, e ka urdhëruar policinë e Dragashit që të njëjtin ta gjej dhe ta sjellë në gjykatë, por pas dy orësh pritje gjyqtari e ka njoftuar se i akuzuari M.M., e ka telefonuar drejtpërdrejtë gjyqtarin dhe e ka njoftuar se gjendet në Itali dhe se do të kthehet me datën 10.07.2024 dhe ka obliguar që së paku njëri nga të dëmtuarit domosdoshmërisht të prezantohet në këtë datë pranë kësaj gjykate. Duke vepruar sipas kërkesës së gjyqtarit F.K., e dëmtuara B.H., edhe pse në gjendje të keqe shëndetësore ka udhëtuar nga Kroacia për në Republikën e Kosovës, në mënyrë që të prezantohet në këtë seancë, mirëpo i akuzuari M.M., përsëri nuk ka prezantuar. Të dëmtuarit janë të pakënaqur me mënyrën e udhëheqjes së kësaj procedure nga ana e gjyqtarit F.K., pasi që i njëjti asnjëherë nuk ka ndërmarrë veprime për të siguruar prezencën e të akuzuarit në seancë, ndërsa për palët e dëmtuara nuk ka hezituar të lëshoj urdhër arrest, pa i ftuar të njëjtit paraprakisht në mënyrë të rregullt. Po ashtu, konsiderojnë se nuk është ligjore e as etike që gjyqtari të komunikoj drejtpërsëdrejti me të akuzuarit përmes telefonit, andaj kërkojnë nga Kryetarja e gjykatës dhe nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, si organe kompetente të shqyrtojnë këtë ankesë dhe të ndërmarrin veprimet e nevojshme që kjo çështje penale të udhëhiqet konform dispozitave ligjore në fuqi dhe shkeljet e adresuara të eliminohen në vazhdim.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar ankesë ndaj gjyqtarit F.K., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, lidhur me lëndën P.nr.42/23 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes si dhe ka bërë shikimin e shkresave të lëndës penale P.nr.42/23.

Gjyqtari në deklaratën e tij lidhur e pretendimet e ankuesit ka cekur se gjykata në këtë çështje ka caktuar seancën me datë 21.11.2023 në ora 10:00 min, ku palët në procedurë, i akuzuari dhe të dëmtuarit nuk kanë prezantuar dhe në flete kthesat qëndron konstatimi se të njëjtit gjenden jashtë shtetit. Gjykata duke vepruar konform dispozitave të KPPRK-së, ka lëshuar urdhëresë për sjellje të akuzuarit dhe të dëmtuarve, mirëpo nga njoftimi policor, gjykata është njoftuar se palët gjenden jashtë Kosovës. Me datë 26.04.2024 në Gjykatën themelore në Prizren është paraqitur i akuzuari M.M., i cili është njoftuar me urdhëresën për sjellje dhe ka kërkuar që të përfundoj këtë lëndë penale duke e pranuar vullnetarisht fajësinë, por gjykata nuk ka vendosur për shkak të mungesës së të dëmtuarve. I akuzuari i ka premtuar gjykatës se me datë 10.07.2024 do të paraqitet në gjykatë pasi që deri me këtë datë gjendet jashtë Kosovës në Itali dhe gjykatës për kontakt i ka dhënë numrin e telefonit mobil. Në gjykatë me datë 10.07.2024 i është paraqitur i dëmtuari R.Sh., së bashku me përfaqësuesin e tij av.A.R., ku në prezencën e tyre gjyqtari e ka kontaktuar nga telefoni zyrtar i gjykatës të akuzuarin M.M., në telefonin mobil, ku i njëjti është paraqitur dhe e ka njoftuar gjykatën se gjendet në Itali dhe sapo të kthehet, vet do të lajmërohet në gjykatë. Andaj, gjyqtari deklaroi se në këtë rast nuk kemi të bëjmë për

kurrfarë dyshimi në udhëheqjen e kësaj çështjeje ngase këtu mungojnë palët në procedurë të cilat gjenden jashtë Kosovës

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar deklaratën nga gjyqtari e çështjes, ka bërë verifikimin e shkresave të lëndës P.nr.42/23.

Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave të mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore në Prizren — dega në Dragash është në punë çështja penale ndaj të pandehurit M.M., nga fshati Restelicë, Komuna e Dragashit për shkak të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 par. 1 të KPRK-së. Lidhur me këtë çështje gjykata me datë 21.11.2023 ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar, e cila nuk është mbajtur për shkak të mungesës së të akuzuarit dhe të dëmtuarve, për të cilët nga fletë kthesa qëndron konstatimi se të njëjtit janë me banim jashtë shtetit. Pas kësaj gjykata me datë 14.12.2023 ka lëshuar urdhëresë për sjellje me dhunë për të akuzuarin dhe të dëmtuarit për seancën e datës 29.12.2023. Po ashtu, edhe kjo seancë nuk është mbajtur përkundër urdhëresave për sjellje, pasi që gjykata përmes policisë është njoftuar se palët gjenden jashtë shtetit. Në këtë drejtim, gjykata me datë 03.01.2024 ka lëshuar urdhër arrest të hapur për të akuzuarin M.M., ndërsa me datë 04.01.2024 ka lëshuar urdhër arrest për të dëmtuarit R.Sh., E.B., I ahir Shuke, B.H., dhe R.Sh., I akuzuari M.M., në ndërkohë është paraqitur në gjykatë, gjyqtari i çështjes me datë 26.04.2024 e ka njoftuar policinë për tërheqjen e urdhër arrestit ndaj të njëjtit ndërsa urdhër arresti ndaj të dëmtuarve ka mbetur aktiv.

Në rastin konkret është vërtetuar se gjyqtari ka zhvilluar procedurën e rregullt të bazuar në dispozitat e KPP me caktimin e shqyrtimit fillestar dhe me dërgimin e ftesave palëve në procedurë. Në bazë të verifikimit të shkresave të lëndës është vërtetuar se në fletëkthesa për të gjithë palët qëndron konstatimi nga ana e postës, se palët të dëmtuar janë shpërngulur në Itali dhe Kroaci, kurse i akuzuari në Itali. Më pas gjyqtari në pamundësi që të zhvillojë procedurën ka urdhëruar sjelljen me dhunë të akuzuarit dhe të dëmtuarve —dëshmitarëve. Nga ana e policisë ka pranuar informatën se nuk mund të sigurohet prania e palëve me datën të cilën gjyqtari ka caktuar për shkak se palët janë jashtë shtetit. Në këtë situatë gjyqtari bazuar në dispozitat e KPP ka lëshuar urdhërarrest ku në ndërkohë i akuzuari është paraqitur në gjykatë dhe ka konfirmuar se do të përgjigjet ftesës së gjykatës dhe me këtë qëllim edhe ka dorëzuar numrin e telefonit për kontakt . Gjyqtari nuk ka pasur mundësi që të mbajë seancën pasi nuk ka mundur të sigurojë prezencën e palëve —të dëmtuarëve—dëshmitarëve ose ti informojë për datën e mbajtjes së seancës. Nga e gjithë e lartëcekura gjykata konstaton se gjyqtari e ka pasur për qëllim që të zhvillojë procedurën dhe të përfundojë bazuar në rregullat e KPP-së dhe në këtë drejtim i ka shfrytëzuar mundësitë ligjore për sigurim të palëve në procedurë, i ka ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat i ka pasur në dispozicion si gjyqtar i rastit dhe sjellja e tij nuk paraqet sjellje të pahijshme ashtu si pretendohet nga ana e ankuesit.

Andaj, si Autoritet Kompetent bazuar në të lartcekura konsideroj se gjyqtari F.K., në veprimet e tija nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë Shkelje sa i përket sjelljes të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit.

Për arsyet e cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**AD-GJTHPZ.nr.10/2024, me dt.19.08.2024**

024

Gjykatës Themelore në Prizren

Shpërsa Emra

parë e drejta e ankesës.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.